



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/81

Datë: 23.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit dhe Objekteve të evidentuara në Certifikatat mbi të drejtat e pronës, Nr.P-71914059-06035-0, O-71914059-06035-0-293-1 dhe O-71914059-06035-0-293-2 me pronar "Banka Themelore e Bankës së Lubjanës në Prishtinë", të cilat ndodhen në Zonën Kadastrale në Prishtinë, Komuna Prishtinë, për nevoja të Qeverisë së Republikës së Kosovës, sipas tabelës së bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Vlerësimi i pronave do të kryhet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në Ministrinë e Financave, në përputhje me aktet nënligjore të miratuara në pajtim me paragrafin 6. të nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ministria e Administratës Publike.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/81

Datë: 23.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për rregullimin e fushës së pensioneve.
2. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/81

Datë: 23.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për çështjen e trajtimit të ndërtimeve pa leje.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/81

Datë: 23.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet, me ndryshime, Koncept-dokumenti për çështjet e Kadastrit.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për përfshirjen e ndryshimeve në tekstin e Koncept-dokumentit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera kompetente, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/81

Datë: 23.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për rregullimin e shërbimeve private të sigurisë në Republikën e Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/81

Datë: 23.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, po ashtu në Vendimin Nr. 03/2016 të Këshillit për Pozita të Nivelit të Lartë Drejtues, të datës 14 mars 2016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Elhami Hajdari, i vazhdohet mandati i Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural edhe për tre (3) vjet.
2. Z. Hajdari kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/81

Datë: 23.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 20 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (GZ. Nr. 31/15 Qershor 2015), duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohen rregullat për lartësinë e kompensimit të anëtarëve të bordeve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore sipas këtij kategorizimi:
 - 1.1. Kategoria I: Telekom i Kosovës, KEK, KOSTT, Posta e Kosovës;
 - 1.2. Kategoria II: Ibër Lepenc, Infrakos, TrainKos, KRU Prishtina, Aeroporti i Gjakovës;
 - 1.3. Kategoria III: Ndërmarrjet tjera të sektorit të ujësjellësit, ujitjes dhe mbeturinave.
2. Kompensimi i anëtarëve të bordeve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore bëhet sipas tabelës së bashkangjitur në shtojcën 1. të këtij vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi Nr. 01/119 i datës 13.03.2013.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca: Tabelat e niveleve të kompensimit për Bordet e Ndërmarrjeve Publike Qendrore

Tabela 1: Nivelet e kompensimit të anëtarëve të Bordeve sipas kategorisë

Kategoria	Pozita	Niveli i kompensimit
Kategoria 1	Kryesues	850
	Anëtar	600
Kategoria 2	Kryesues	650
	Anëtar	460
Kategoria 3	Kryesues	450
	Anëtar	320

Tabela 2: Nivelet e kompensimit të anëtarëve të Komiteteve të Auditimit sipas kategorisë

Kategoria	Pozita	Niveli i kompensimit
Kategoria 1	Kryesues	200
	Anëtar	150
Kategoria 2	Kryesues	155
	Anëtar	115
Kategoria 3	Kryesues	110
	Anëtar	80



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr.08/81

Datë: 23.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (G.Z.nr.31/15 Qershor 2008), nenit 6 të Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (G.Z.nr 13/30 Maj 2012), duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Ndërmarrja Publike Lokale NPL "Prishtina Parking" Sh.A - Prishtinë.
2. Ndërmarrja Publike Lokale NPL "Prishtina Parking" Sh.A, themelohet me 100% Aksione nga Kuvendi Komunal i Prishtinës.
3. Komuna e Prishtinës autorizohet që të veprojë në emër të aksionarit të vetëm në NPL "Prishtina Parking" Sh.A dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e ligjshme duke përfshirë regjistrimin sipas Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare (GZ Nr. 39 / 01 tetor 2008).
4. Komuna e Prishtinës të drejtat e saj të aksionarit do t'i ushtrojë nga Komisioni Komunal i Aksionarëve, në emër të Komunës në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Obligohet Komuna e Prishtinës për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Komunës së Prishtinës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/81

Datë: 23.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (G.Z.nr.31/15 Qershor 2008), nenit 6 të Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (G.Z.nr 13/30 Maj 2012), duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Ndërmarrja Publike Lokale NPL "Ambienti" Sh.A - Ferizaj.
2. Ndërmarrja Publike Lokale NPL "Ambienti" Sh.A - Ferizaj, themelohet me 100% Aksione nga Kuvendi Komunal i Ferizajt.
3. Komuna e Ferizajt autorizohet që të veprojë në emër të aksionarit të vetëm në NP "Ambienti" Sh.A dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e ligjshme duke përfshirë regjistrimin sipas Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare (GZ. Nr. 39/01 tetor 2008).
4. Komuna e Ferizajt të drejtat e saj të aksionarit do t'i ushtrojë nga Komisioni Komunal i Aksionarëve, në emër të Komunës në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Obligohet Komuna e Ferizajt për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Komunës së Ferizajt
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/81

Datë: 23.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 250.000 (dyqindpesëdhjetë mijë) euro, për realizimin e planit për subvencionimin e projekteve filmike nga Qendra Kinematografike e Kosovës.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nënprogrami Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100 kategoria ekonomike e rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me kod organizativ 207, nënprogrami Përkrahja Institucionale për Kulturën me kod 80300, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/81

Datë: 23.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 21 të Rregullores (QRK) nr. 21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet organizata joqeveritare ECMI Kosova për mbështetjen e punës së Komisionit për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së veriut (UMV).
2. Autorizohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për lidhjen e memorandumit të mirëkuptimit me ECMI Kosova më qëllim të lehtësimit të kontakteve me UVMV-ën, verifikimit të dokumentacionit mbështetës, përmirësimit të qasjes për dorëzimin e aplikacioneve, mbështetjes administrative të Komisionit-Sekretarisë për pranimin e aplikacioneve dhe kryerjen e detyrave tjera të përcaktuara me memorandum.
3. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/81

Datë: 23.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2016 të Qeverisë së Republikës së Kosovës

1. Në Programin Legjislativ të vitit 2016 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfshihen këto projektligje:
 - 1.1. Projektligji për Ratifikimin e Konventës për Heqjen e Kërkesës për Legalizimin e Dokumenteve Zyrtare të Huaja (e vitit 1961), 15.03.2016 (MPJ);
 - 1.2. Projektligji për Ratifikimin e Konventës për Zgjidhjen Paqësore të Mosmarrëveshjeve Ndërkombëtare (e vitit 1907), 30.06.2016 (MPJ);
 - 1.3. Projektligji për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, 15.06.2016 (MF);
 - 1.4. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-033 si dhe Ligjin Nr. 04/L-115, 31.03.2016 (MD);
 - 1.5. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, 30.06.2016 (MD).
2. Ndryshohet afati kohor për dërgimin e projektligjeve për miratim në Qeveri, si në vijim:
 - 2.1. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, 15.06.2016 (MF);
 - 2.2. Projektligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, 01.06.2016 (MF).
3. Projektligji për Inspektime bartet nga Zyra e Kryeministrit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, 31.10.2016 (MTI).

4. Ngarkohet Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/81

Datë: 23.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-033 si dhe Ligjin Nr. 04/L-115.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/81

Datë: 23.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Maltës, për Promovimin dhe Mbrojtjen e Investimeve.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë